



INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-së SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (IV) IFAQE 4-5

EURODEPUTETI OLIVIER DUPUIS, "PËRFAQËSUES POLITIK" I UÇK-së NË PARLAMENTIN EUROPIAN





"Edhe sikur ajri i pastër të vinte vetëm nga Serbia dhe jeta ime të ishte e varur prej tij, të isha shqiptare nuk do ta blija! Do të më dukej përbuzje ndaj të gjitha viktimave!"
(ish senatorja belge, Anne-Marie Lizin, 1999)

Pas takimit të Bardhyl Mahmutit me ministrin e Jashtëm holandez UÇK-ja u premtonte lëvizje të sigurt vëzhguesve në Kosovë

"Mahmuti tha se UÇK-ja do të vazhdojë të respektojë armëpushimin dhe do t'u garantojë siguri verifikuesve të OSBE-së", tha zëdhënësi i ministrit të Jashtëm pas takimit

delegacioni i shqiptarëve të Kosovës në Parlamentin Evropian në Bruksel

UÇK-ja, për herë të parë, shpreh platformën e saj para Parlamentit Evropian

Doris Pack: "UÇK-ja ka lindur si pasojë e aparteidit dhjetëvjeçar në Kosovë dhe për këtë mbajmë përgjegjësi edhe ne, edhe Amerika"

Bardhyl Mahmuti: "Ju të nderuar deputetë të këtij Parlamenti, apo prindërit tuaj, nuk kemi pritur demokracizimin e Gjermanisë nazifashiste gjatë Luftës së Dytë Botërore, por kemi rrokur armët për t'u çliruar kështu që këtë të drejtë nuk mund të na mohoni as ne"

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive, në vazhdimin e pjesës së katërt, ka theksuar se heqja e cilësimit "terrorist" dhe afirmimi ndërkombëtar i UÇK-së si organizatë çlirimtare që duhej të përfshihej në bisedimet për ardhmërinë politike të Kosovës hapi rrugë për një aktivitet intensiv diplomatik. Ai ka folur për takimet shumë të rëndësishme që kanë pasur në institucionet e BE-së dhe fjalimin e tij në Parlamentin Evropian për ta përkuhruar luftën e UÇK-së, duke theksuar se kontribut të madh për organizimin e këtyre takimeve ka pasur aktivisti i shquar për mbrojtjen e të drejtave, Paul Staal. Në këtë intervistë Bardhyl Mahmuti tregon se si deputeti me origjinë belge, Olivier Dupuis, mbështeti fjalimin e tij dhe doli në përkrahje publike të luftës çlirimtare të popullit shqiptar të Kosovës

OPINION

REFORMA FISKALE NË KOSOVË UL VARSHMËRINË E BIZNESEVE NDAJ KREDIVE TË BANKAVE KOMERCIALE F. 8

Shkruan: Safet GËRXXHALIU, ish-kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës



AKTUALE



BLINKENI SËRISH NË IZRAEL PAS TURNEUT NË SHTETET ARABE F. 2

PARLAMENTI EVROPIAN DO TË KËRKOJË MASA NDËSHKUESE NDAJ SERBISË F. 7

NË QKUK SHKURTOHET LISTA E PRITJES PËR REZONANÇË MAGNETIKE F. 3

EKONOMI

KOSOVA, NJË VEND ME POTENCIAL TË JASHTËZAKONSHËM PËR INVESTIME TË HUAJA DHE NDËRMARRËSI F. 8

SPORT



"EURO 2024", JASIR ASANI: PLISI NA FORCOI ZEMRËN PËR NË BERLIN F. 10

SAMITI I BERLINIT NË TIRANË, DEBATI U FOKUSUA NË BASHKËPUNIMIN EKONOMIK, ZGJERIMIN E BE-SË DHE SITUATËN NË VERI IFAQE 5



Samiti i Berlinit e ktheu të hënën Tiranën në kryeqendër të politikës dhe medias evropiane. Në tryezën e përbashkët të udhëheqësve të Bashkimit Evropian dhe të atyre të Ballkanit Perëndimor u diskutua për shumë tema, por u veçuan bashkëpunimi ekonomik, zgjerimi i BE-së, situata e fundit në veri dhe ngjarjet e fundit në Izrael pas sulmit të Hamasit

RENOVA PUTZ

Maqedoni Xhepcisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.

NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI

www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Data Systems” L.L.C, K. Prishtinë bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Kompaninë “Data Systems” L.L.C, K. Prishtinë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 29.11.2023 në ora 14:30 në Shkollën fillore “Filip Shiroka” Fshati Slivovë - Komuna e Prishtinës, do të organizohet debat publik nga Kompania “Data Systems” L.L.C, K. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për Parkun e Energjisë me Erë “Mareci” 34.5 MW.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Zoom:
Join Zoom Meeting

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943
Passcode: 123456

[Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së](#) për Kompaninë “Data Systems” L.L.C, K. Prishtinë, për Parkun e Energjisë me Erë “Mareci” 34.5 MW

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin ynm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Prishtina Energy” Sh.p.k, K. Prishtinë bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Kompaninë “Prishtina Energy” Sh.p.k, K. Prishtinë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 29.11.2023 në ora 13:30 në Shkollën fillore “Filip Shiroka” Fshati Slivovë - Komuna e Prishtinës, do të organizohet debat publik nga Kompania “Prishtina Energy” Sh.p.k, K. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për Parkun e Energjisë me Erë “Koznica” 35 MW.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Zoom:
Join Zoom Meeting

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943
Passcode: 123456

[Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së](#) për Kompaninë “Prishtina Energy” Sh.p.k, K. Prishtinë, për Parkun e Energjisë me Erë “Koznica” 35 MW.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin ynm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Arsin Kasimllar shpall të pavlefshme diplomen shme “Ymer Prizreni” Prizren.
- Dren Nicha shpall të pavlefshme deftesat dhe diplomen shme “Ymer Prizreni” Prizren.
- Eslem Gashi shpall të pavlefshme deftesat, certifikaten , diplomen Q.K. “11 Marsi “ Prizren.
- Munir Anadolu shpall të pavlefshme deftesat dhe diplomen shme “ Ymer Prizreni “ Prizren.
- Nuridin Isljami shpall të pavlefshme 4 deftesat dhe diplomen Q.K.”11 Marsi “ Prizren.
- Taulant Gashi shpall të pavlefshme 4 deftesat Q.K “11 Marsi “ Prizren.
- Nuhi Rexhepi shpall të pavlefshme diplomen Q.K. “11 Marsi “ Prizren.
- Hami Ramadan Bajraliu shpall të pavlefshme Diplomën e Universitetit të Prishtinës, drejtimi Ekonomik me nr. 742.
- Anita Uka shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore nga kl. parë deri të nëntën të shkollës “Nazim Gafurri” Prishtinë.
- Naser Shunjaku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike “Nexhmedin Nixha”.
- D.P.H. “Burimi” shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330286147-Gjilan.
- Bulent Bytyqi shpall të pavlefshme 4 dëftesat shme “ Ymer Prizreni “Prizren.
- Fikret Ajazaj shpall të pavlefshme diplomën shme “ Ymer Prizreni “ Prizren.
- Egzona Rustemi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. dhjetë (X), njëmbëdhjetë (XI) dymbëdhjetë (XII) si dhe Diplomën e Gjimnazit “Naim Frashëri” Shtime.
- AGRON PEÇI, shpall të pavlefshme dëftesën 1-8 SHFMU “MUHARREM BEKTESHI”.

Blinkeni sërish në Izrael pas turneut në shtetet arabe

JERUSALEM, 16 TETOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, është rikthyer në Izrael për herë të dytë në më pak se një javë për konsulta me zyrtarët e lartë izraelitë pas diskutimeve që pati me liderët arabë për luftën në mes të Izraelit dhe Hamasit. Blinken arriti në Tel Aviv më 16 tetor pasi vizitoi gjashtë shtete arabe, ku dëgjoi shqetësimet e

liderëve arabë për një sulm tokësor të Gazës që do të shkaktojte një katastrofë humanitare për palestinezët dhe, ndoshta, do të nxiste një konflikt më të gjerë rajonal. Ai do të zhvillojë bisedime me kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu dhe anëtarët e ekipit të tij të sigurisë kombëtare, përderisa Shtëpia e Bardhë po e



Izraeli thotë se afër 200 pengje po mbahen në Gazë

GAZA, 16 TETOR - Ushtria izraelite tha se Hamas dhe militantët e tjerë palestinezë janë duke mbajtur 199 pengje në Gazë. Ky është numër më i lartë i pengjeve sesa vlerësimet paraprake. Admirali Daniel Hagari, zëdhënës i ushtrisë izraelite, tha të hënën se familjarët e

pengjeve janë njoftuar. Ai nuk specifikoi se sa shtetas të huaj gjenden në Gazë në mesin e pengjeve, apo se kush po i mban ata. Shumica besohet se po mbahen pengje nga grupi militant i Hamasit. Ky grup kontrollon Gazën që nga viti 2007.



shqyrton mundësinë që presidenti amerikan Joe Biden ta vizitojë Izraelin gjatë kësaj jave. Blinkeni, po ashtu, do të takohet ndaras me presidentin izraelit Isaac Herzog, ministrin e Mbrojtjes Yoav Gallant dhe liderin opozitar Yair Lapid. Bideni, Blinkeni dhe zyrtarë të tjerë të lartë amerikanë kanë premtuar mbështetje të palëkundur me Izraelin, përderisa ky shtet po kundërpërgjigjet ndaj sulmeve vdekjeprurëse të grupit militant, Hamas, që kanë lënë të vrarë mbi 1 400 izraelitë që nga java e kaluar. Por, përderisa planet e Izraelit për një sulm ushtarak për ta zhdukur Hamasin po zhvillohen, shtetet arabe dhe të

tjerët kanë ngritur alarmin për numër të lartë të viktimave civile dhe për një krizë të madhe humanitare. Pasi vizitoi Izraelin të mërkurën e kaluar për ta shprehur solidaritetin amerikan, Blinkeni udhëtoi në rajon, duke u takuar me liderët e Jordanisë, Autoritetit Palestinez, Katarit, Bahrejnit, Emirateve të Bashkuara Arabe, Arabisë Saudite dhe Egjiptit. Të gjithë liderët e këtyre shteteve arabe kërkuar që civilët të mbrohen dhe t'u ofrohet ndihmë për ta mbijetuar operacionin izraelit. Përderisa shqetësimet u rritën, ShBA-ja, po ashtu, ka kërkuar që Izraeli t'i respektojë ligjet e luftës sa i përket trajtimit të civilëve. Blinkeni dhe zyrtarët e tjerë po


shqyrtojnë edhe idenë e krijimit të zonave të sigurta në Rripin e Gazës dhe që ndihma humanitare të arrijë te civilët. Hamasi nisi sulme ajrore, tokësore dhe detare ndaj Izraelit më 7 tetor. Izraeli u kundërpërgjigj ashpër, duke bombarduar Rripin e Gazës. Si pasojë e dhunës, në Izrael janë vrarë mbi 1 400 izraelitë, ndërkaq në Rripin e Gazës janë raportuar 2 670 palestinezë të vrarë. Izraeli ka urdhëruar mbi 1 milion palestinezë të evakohen në jug të Gazës. Ky shtet ka thënë se po tenton t'i largojë civilët para se të ndërmarrë një fushatë të madhe kundër Hamasit në veri të Rripit të Gazës.

Gjermania i shton kontrollet kufitare për ta parandaluar valën e re të emigrantëve

BERLIN, 16 TETOR - Gjermania njoftoi të hënën se do t'i shtojë kontrollet kufitare përgjatë kufijve lindorë dhe jugorë për shkak të rritjes së numrit të emigrantëve.

Berlini e njoftoi Bashkimin Evropian (BE) për kontrolle të shtuara në pikat kalimtare me Republikën e Çekisë, Poloninë dhe Zvicrën, për ta parandaluar trafikimin dhe emigrimin e parregullt, tha Ministria e Brendshme e Gjermanisë në një komunikatë. "Tani është e nevojshme të merren të gjitha masat e mundshme për ta ndaluar këtë biznes mizor", tha ministrja e Brendshme Nancy Faeser.

Derisa Zvicra nuk është në BE, ajo është pjesë e Zonës Shengen për kufij të hapur, bashkë me Gjermaninë, Poloninë dhe Republikën e Çekisë.



Brenda Zonës Shengen kontrollet kufitare lejohen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe para se

të zbatohen ato, duhet të njoftohet Brukseli. Gjermania, po ashtu, e njoftoi BE-në për zgjatjen e

kontrolleve ekzistuese kufitare me Austrinë, që nisën pas krizës me emigrantë nga viti 2015, kur qindra mijëra njerëz

u futën vrullshëm në Gjermani. Kontrollet e reja me Republikën e Çekisë, Poloninë dhe Zvicrën do të zgjasin 10 ditë duke nisur nga sot dhe mund të zgjaten deri në dy muaj maksimum, tha Ministria. Kontrollet me Austrinë do të zgjaten për gjashtë muaj nga 12 nëntori. "Ne duam t'u kthehemi kufijve të brendshëm, ku nuk do të kemi nevojë të kryejmë kontrolle", tha Faeser, duke theksuar rëndësinë e rregullave të përbashkëta evropiane. Gjermania i rriti kontrollet e sigurisë përgjatë kufijve me Poloninë dhe Çekinë në shtator, duke e dyfishuar numrin e kontrolleve për ta luftuar ardhjen e emigrantëve të rinj. Në shtator Gjermania i regjistroi mbi 250 000 kërkesa për azil vetëm nga janari, më shumë se tërë vitin 2022.

Samiti i Berlinit në Tiranë, debati u fokusua në bashkëpunimin ekonomik, zgjerimin e BE-së dhe situatën në veri

Samiti i Berlinit e ktheu të hënën Tiranën në kryeqendër të politikës dhe medias evropiane. Në tryezën e përbashkët të udhëheqësve të Bashkimit Evropian dhe të atyre të Ballkanit Perëndimor u diskutua për shumë tema, por u veçuan bashkëpunimin ekonomik, zgjerimi i BE-së, situata e fundit në veri dhe ngjarjet e fundit në Izrael pas sulmit të Hamasit

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

TIANË, 16 TETOR - Udhëheqësit e Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor u pritën të hënën në Tiranë nga kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në ambientet e kryeministrisë, për të vazhduar më pas Samitin e Procesit të Berlinit.

Pas ceremonisë së pritjes, liderët iu drejtuan Piramidës, aty ku po zhvillohen punimet e Samitit. Në hyrje të samitit, kryeministri Edi Rama vuri theksin te ndasitë mes vendeve anëtare dhe atyre joanëtare të Bashkimit Evropian. Sipas tij, premtimet ekonomike të Procesit të Berlinit nuk janë realizuar. "Sfida më e madhe politike është ndarja e dhimbshme mes anëtarëve të BE-së dhe joanëtarëve. Të jetosh pa BE-në nuk është e lehtë. A mund t'i përballojmë këto ndasi? Premtimet ekonomike të Procesit të Berlinit nuk janë realizuar, sidomos kur krahasohet me mendësinë transformuese që ka sjell", ka pohuar ai.

Kancelari gjerman Olaf Scholz, njëherësh 'arkitekt' i Procesit të Berlinit, tha se samiti i Procesit të Berlinit provoi rëndësinë e pamohueshme të Ballkanit Perëndimor në union. Sipas Scholzit, ndikimi i marrëveshjeve të firmosura vitin e kaluar të Procesit të Berlinit kanë qenë konkrete dhe priten edhe të tjera. Megjithatë, pas agresionit në veri të Kosovës, ka ardhur koha të tejkalohej konfliktet që mbajnë rajonin në vendnumëro. "Të nderuar kolegë që jemi mbledhur këtu, ne e dimë që kemi një situatë shumë të pazakontë jo shumë larg nesh me agresionin e Hamasit kundër Izraelit dhe të gjitha pasojat që ka dhe do të ketë. Dhe po, edhe krizat e

shumëfishta këtu në rajonin e Ballkanit Perëndimor kanë theksuar nevojën emergjente për të punuar së bashku dhe tejkaluar antagonizmat. Ka ardhur koha për t'i tejkaluar konfliktet që kanë vijuar për një kohë shumë të gjatë duke ju mbajtur juve në vendnumëro. Përshkallëzimet e fundit në veri të Kosovës kanë vërtetuar sa e rëndësishme është kjo. Ne do të përfundojmë më në fund zbatimin e marrëveshjeve të cilat janë arritur me anën e dialogut të normalizimit të udhëhequr nga BE-ja. Dhe jam shumë i kënaqur që për herë të parë ky samit organizohet në një vend të Ballkanit Perëndimor", ka thënë ai, duke shtuar se është një sinjal i fortë që tregon në këtë rast pronësinë që ka rajoni në këtë proces. "Ne duhet ta përdorim këtë rast për t'u përqendruar te të gjitha shoqëritë e Ballkanit Perëndimor dhe ky është integrimi dhe ecuria e mëtejshme në rrugëtimin drejt BE-së. Vitin e shkuar ju keni marrë disa hapa madhorë në lidhje me nënshkrimin e tri marrëveshjeve të lëvizshmërisë dhe jam shumë mirënjohës që 4 nga 6 shtete i kanë ratifikuar ato deri më tani. Ndikimi i tyre te qytetarët e Ballkanit Perëndimor është vërtet konkret, sepse qytetarët mund të lëvizin me kartë identiteti, mund të kryejnë studimet. Ecuria që do të keni sa i përket zhvillimit të brendshëm rajonal është vërtet e rëndësishme dhe për këtë mund të mbështeteni te Gjermania, te qeveria jonë. Ky është procesi i Berlinit. Le të vijojmë duke bërë gjithçka realitet", ka thënë Scholz. Edhe presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, theksoi rëndësinë e integritetit të Ballkanit Perëndimor në



Bashkimin Evropian. Michel tha se të dyja palët duhet të jenë gati për zgjerim deri në vitin 2030. "Zgjerimi është investim në paqen dhe begatinë e BE-së dhe anëtarëve tanë të ardhshëm. Rrugëtimi juaj ka nisur më shumë se 20 vjet më parë në BE. Ka qenë një rrugë shumë e ngadaltë. Zhgënjyese. Por tani, besoj se duhet të jemi gati në të

dyja anët deri në 2030-n për t'u zgjeruar. Lufta në Ukrainë e ka përqendruar vëmendjen tonë te zgjerimi", ka deklaruar ai. Kryetarja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, tregoi qëllimin e unionit për t'i dhënë qasje Ballkanit Perëndimor në tregun e përbashkët evropian. "Për këtë arsye kam prezantuar planin e rritjes. Duam që t'u

japim qasje në tregun e përbashkët evropian. Për këtë, na duhen reforma në Ballkanin Perëndimor dhe ata që kanë vullnetin të reformohen, do të marrin financim nga Bashkimi Evropian. Është një stimul për ata që vërtet duan të ecin përpara. Dyert tona janë të hapura, kështu që le të punojmë ta çuar para këtë plan rritjeje", ka theksuar ajo.

Kurti: Qytetarët në Ballkanin Perëndimor të punojnë për një të ardhme së bashku

Kryeministri Albin Kurti, i cili ishte i pranishëm në këtë samit, ka thënë se qytetarët në Ballkanin Perëndimor sot nuk duhet të jetojnë nën frikën e një konflikti nesër, por të punojnë për një të ardhme së bashku. "Ne si udhëheqës të tyre kemi përgjegjësinë për të ndërtuar atë të ardhme të përbashkët. Dhe si udhëheqës, ne duhet të përfshihemi në atë proces me mirëbesim. Kërkojmë një angazhim me mirëbesim për ta garantuar efektivitetin afatgjatë të marrëveshjeve tona dhe respektimin e të gjitha palëve të

investuara në proces. Vitin e kaluar ne nënshkruam tri marrëveshje mobiliteti, një hap i rëndësishëm drejt rezultateve të prekshme. Përderisa që e vlerësojmë progresin, ai do të mund të ishte edhe më i shpejtë. Fatkeqësisht, mospërfillja e një marrëveshjeje kyçe për lirinë e lëvizjes nga ana e Bosnjës dhe Hercegovinës do të thotë se vazhdon kushti për viza ndërmjet Kosovës dhe Bosnjës", ka thënë Kurti. Ai ka thënë se BE-ja mund të reformohet dhe të zgjerohet. "Unë gjithashtu besoj se përfitimet e Tregut Unik të BE-së duhet të

lidhen me reformat ekonomike dhe demokratike. Nuk duhet të ketë përfitime të BE-së dhe as fonde të BE-së pa vlerat e BE-së. Ne jemi të vetëdijshëm për hendekun thelbësor të standardeve të jetesës me BE-në, i cili do të kërkojë kohë për t'u mbyllur. Së bashku ne duhet të vazhdojmë të punojmë drejt rritjes së qëndrueshme për rajonin tonë. Kosova, një demokraci e gjallë, është e përgatitur të përballet me sfida të reja dhe ta përqafojë një të ardhme më të ndritshme", ka thënë Kurti.

Në QKUK shkurtohet lista e pritjes për rezonancë magnetike

PRISHTINË, 16 TETOR - Bazuar në raportin e Klinikës së Radiologjisë, është zvogëluar lista e pritjes për raste ambulatore për Rezonancë Magnetike (MRI) në vetëm tre muaj e gjysmë, nga më shumë se një vit sa ishte më parë, përderisa për pacientët e shtrirë në klinika, nuk ka fare listë të pritjes.

Bazuar në raportin 9-mujor të punës, në Klinikën e Radiologjisë janë kryer 9 683 rezonanca magnetike, 23 751 pacientë në Tomografi të Kompjuterizuar (CT). Brenda muajit në Klinikën e Radiologjisë kryhen 12 500 deri në 14 000 ekzaminime të ndryshme diagnostike për pacientët.

Qendra Klinike Universitare e Kosovës aktualisht ka në funksion tri rezonanca magnetike, gjë që ka mundësuar të bëhet shkurtime i listave të pritjes. Këtë shkurtime e ka ndihmuar edhe instalimi i aparatit të rezonancës magnetike në Spitalin e Pejës.





INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-SË SI “ORGANIZATË TERRORISTE”? (IV)

Eurodeputeti Olivier Dupuis, ‘përfaqësues politik’ i UÇK-së në Parlamentin Europian

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive, në vazhdimin e pjesës së katërt, ka theksuar se heqja e cilësimit “terrorist” dhe afirmimi ndërkombëtar i UÇK-së si organizatë çlirimtare që duhej të përfshihej në bisedimet për ardhmërinë politike të Kosovës hapi rrugë për një aktivitet intensiv diplomatik. Ai ka folur për takimet shumë të rëndësishme që kanë pasur në institucionet e BE-së dhe fjalimin e tij në Parlamentin Evropian për ta përkrahur luftën e UÇK-së, duke theksuar se kontribut të madh për organizimin e këtyre takimeve ka pasur aktivisti i shquar për mbrojtjen e të drejtave, Paul Staal. Në këtë intervistë Bardhyl Mahmuti tregon se si deputeti me origjinë belge, Olivier Dupuis, mbështeti fjalimin e tij dhe doli në përkrahje publike të luftës çlirimtare të popullit shqiptar të Kosovës

PRISHINË, 16 TETOR -

“Epoka e re”: Nga një numër i konsiderueshëm shkrimesh që u publikua në atë kohë në mediet vendore dhe ndërkombëtare, del në mënyrë të pakontestueshme se Përfaqësuesi i Përgjithshëm Politik i UÇK-së, z. Adem Demaçi, zëdhënësi i saj, z. Jakup Krasniqi dhe ju vazhdimisht mohoni përfshirjen e UÇK-së në këto vrasje dhe përgjegjëse për krimet ndaj civilëve të të gjitha përkatësive etnike në Kosovë e bënit Shërbimin e fshehtë serb. A kishit ndonjë element që lidhej me kontekstin politik që do të ndihmonte t’i shpjegonte arsyet përse Serbia do të bënte një krim kaq të shëmtuar edhe kundër adoleshentëve serbë dhe malazezë?

Bardhyl Mahmuti: Heqja e

cilësimit “terrorist” dhe afirmimi ndërkombëtar i UÇK-së si organizatë çlirimtare që duhej të përfshihej në bisedimet për ardhmërinë politike të Kosovës hapi rrugë për një aktivitet intensiv diplomatik.

Një muaj pas shpalljes së armëpushimit në mënyrë të njëanshme nga UÇK-ja, ne u ftuam në takime shumë të rëndësishme në institucionet e BE-së. Me sa mbaj mend, Adem Demaçi nuk mundi të vinte në Bruksel për disa arsye objektive. Prandaj në këto takime më shoqëroi Sabri Kiçmari, anëtar i Grupit Diplomatik i UÇK-së. Vlen të përmendim se një kontribut të madh për organizimin e këtyre takimeve ka pasur aktivisti i shquar për mbrojtjen e të drejtave

të njeriut dhe drejtuesi i organizatës joqeveritare holandeze “Press Now”, z. Paul Staal.

Fillimisht organizatorët kishin paraparë që pjesëmarrja jonë të ishte në kuadër të delegacionit të përbashkët të Kosovës, i përbërë nga tre drejtues të LDK-së (Fehmi Agani, Alush Gashi dhe Edita Tahiri) dhe publicisti Veton Surroi. Ne ua bëmë me dije se e shihnim të domosdoshme që, në të gjitha takimet, të kishim kohën tonë për t’i shpjeguar pikëpamjet dhe orientimet e UÇK-së, sepse pikërisht kundër nesh Serbia bënte shpifjet më të mëdha. Debatet rreth kërkesave tona zgjatën tërë pasdarmen dhe, rreth orës 2:00 të mëngjesit, nënshkruam marrëveshjen.

Brenda tri ditësh (10, 11 dhe 12 nëntor 1998) ne zhvilluam një sërë takimesh shumë të rëndësishme. Do të flas më gjerësisht rreth këtyre takimeve, për arsye se mund të hapin një shteg të ri për ta kuptuar intensifikimin e vrasjeve të civilëve të të gjitha përkatësive etnike në Kosovë nga ana e regjimit të Millosheviqit dhe fushatën propagandistike për t’ia veshur UÇK-së këto krime.

Takimin e parë e patëm në Parlamentin Evropian. Kryesuesja e Komisionit për Politikë të Jashtme të Parlamentit Evropian, zonja Doris Pack, reagoi shumë keq kur e kuptoi se agjenda kishte ndryshuar dhe, sipas marrëveshjes së re, neve duhej të na jepej minutazh i njëjtë sikurse delegacionit të LDK-së.

Me zonzën Pack isha takuar edhe dy herë të tjera në kuadër të takimeve për pozitën e shqiptarëve në Maqedoni (në këto takime përfaqësoja LPK-në, ndërkaq Shaip Bilalli, Partinë për Prosperitet Demokratik në Maqedoni). Gjuha që përdori ishte krejtësisht e ndryshme nga ajo që mbaja në mend nga takimet e mëparshme. Me një gjuhë kërcënuese na kërkoi ta prananim agjendën e vjetër, përndryshe nuk do të na linte të hynim në sallën e parlamentit. Ia

bëra me dije se nuk mund të fliste me ne me atë gjuhë dhe nëse nuk kishim mundësi t’i shpallnim pikëpamjet tona përpara parlamentarëve evropian, do ta bënim në konferencë me gazetarët e akredituar në këtë institucion të BE-së. Pesë minuta pas largimit të saj në mënyrë demonstrative, u kthye sërish te ne. Na kërkoi falje për sjelljet e saj dhe u morëm vesh për modalitetet e paraqitjes sonë.

“Epoka e re”: Për aq sa më kujtohet, në këtë rast ju shpërndatë një material prej 120-faqesh që dëshmonte për shkeljet nga ana e Serbisë të rekomandimeve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të bashkuara, mosrespektimin e armëpushimit dhe krimet që ishin bërë gjatë kësaj kohe.

Bardhyl Mahmuti: Po! Ishin të dhëna që kryesisht kishte publikuar Qendra për Informim e Kosovës, e udhëhequr nga Enver Maloku. Zonja Pack pranoi që këtë material t’ua shpërndajë 650 deputetëve të Parlamentit Evropian.

Gjatë 30 minutave që ishin rezervuar për fjalën time, shtrova shtyllat kryesore të orientimit politik të UÇK-së dhe mjeteve që përdornim në luftën tonë çlirimtare. Në mënyrë të veçantë

u ndala rreth mjeteve që përdornim në luftën tonë çlirimtare dhe qëndrimin tonë kategorik që përjashtonte çfarëdo forme të aksioneve terroriste. Në fund kërkova nga deputetët e Parlamentit Evropian që ta përkrahin UÇK-në dhe luftën tonë, si një e drejtë e pakontestueshme e një populli të robëruar. Pas fjalës sime u hap debat ku deputetët shprehnin qëndrimet e tyre rreth luftës sonë.

"Epoka e re": Pa fjalës suaj dhe kërkesës për mbështetje të UÇK-së, si reagan deputetët e Parlamentit Evropian?

Bardhyl Mahmuti: Ndër të parët që mori fjalën ishte deputeti me originë belge, z. Olivier Dupuis (Olivie Dypyi), që ishte zgjedhur si deputet i Listës Emma Bonino (Partia Radikale Transnacionale). Ai e mbështeti tërësisht fjalimin tim dhe doli në përkrahje publike të luftës çlirimtare të popullit shqiptar të Kosovës. Fjala e tij pati aq jehonë sa që njëri nga deputetët, emri i të cilit nuk më kujtohet, deklaroi se në të ardhmen UÇK-ja do të ketë z. Olivier Dupuis si përfaqësues të vetin politik në Parlamentin Evropian. Kishte deputetë që kërkuan mendimin tonë përse nuk ndërprisnim luftën e armatosur dhe, në vend të konfrontimeve me pasojë të mëdha, të bashkoheshim politikisht me opozitën serbe për ta rrëzuar Slllobodan Millosheviqin nga pushteti dhe pastaj t'i realizonim të drejtat tona politike në kuadër të një Serbie demokratike.

Megenëse në mesin e deputetëve kishte të moshuar, ndoshta edhe pjesëmarrës të Luftës së Dytë Botërore, u përgjigja me përmbyse të perspektivës së kësaj çështjeje, përgjigje që pati jehonë të madhe në mediet e asaj kohe: "Ju të nderuar deputetë të këtij parlamenti, apo prindërit e juaj, nuk keni pritur demokratizimin e Gjermanisë naziste gjatë Luftës së Dytë Botërore, por keni rrokur armët për t'u çliruar. Këtë të drejtë legjitime nuk mund t'ia mohoni as popullit tonë të robëruar".



Krahasimi i Serbisë së Millosheviqit me Gjermaninë e Hitlerit nuk i pëlqeu zonjës Doris Pack dhe e konsideroi të pavend. Mirëpo disa deputetë reagan ndaj saj duke më mbështetur plotësisht, ndërkaq z. Olivier Dupuis kërkoi që Parlamenti Evropian ta përkrahte iniciativën që kishte ndërmarrë, që Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë të ngrinte padi kundër Slllobodan Millosheviqit për krimet në Kosovë. Pas prezantimit në Parlamentin Evropian u pritëm në Komisionin Evropian, ku shtruan kërkesa për nevojën për ta ngritur shkallën e mobilizimit me qëllim që të shmangej thellimi i katastrofës humanitare që përjetonte popullsia civile shqiptare e Kosovës, kërkuaam ndihmë për transferimin e të plagosurve në spitalet europiane, ndihmë në barna, në mjete për t'u strehuar dhe ndihma për UÇK-në mbi supet e së cilës kishte rënë barra e kësaj krize humanitare. Takimi vijues u bë me senatorë të Belgjikës, në mesin e të cilëve kishte edhe të atillë që shprehnin brengosje se kërkesa jonë për pavarësi nënkuptonte ndryshim të kufijve dhe rrjedhimisht destabilizim të paqes së

qëndrueshme. Madje një senator kërkoi të mendonim rreth ndonjë zgjidhje kompromisi (autonomi të zgjeruar) që nuk do t'i cenonte kufijtë. Qëndrimi ynë ishte i qartë: BE-ja duhet të dalë nga logjika e mitizimit të kufijve, sepse këta kufi ishin të padrejtë dhe gjeneratorë të konflikteve të vazhdueshme. Përmendëm shembuj të shumtë të ndryshimit të kufijve gjatë procesit të dekolonializmit (në Afrikë dhe në Azi) dhe gjatë procesit të shpërbërjes së federatave socialiste të BRSS dhe të Jugosllavisë. Gjatë fjalës sime dy herë e theksova se Serbia ka hapur një hendek të madh ndërmjet saj dhe Kosovës dhe e ka mbushur plot e përplot kufoma fëmijësh, grash, pleqsh dhe shqiptarësh të të gjitha moshave. Vetëm pavarësia e Kosovës është garanci për paqe të qëndrueshme. Për ne ishte kënaqësi që gjatë këtij takimi gjetëm mbështetje të madhe nga një numër i konsiderueshëm senatorësh, në mesin e të cilëve u dallua senatorja Anne-Marie Lizin, mikeshë e Adem Demaçit, me të cilën kishim shkëmbyer mendimet tona disa muaj më parë, në Selinë e OKB-së në

Gjenevë. Në këtë rast po bëj një shmangie të vogël nga tema dhe po sqaroj për lexuesin se bëhet fjalë për senatoren e cila në takimin që patëm në Prishtinë pas çlirimit të Kosovës deklaroi pa asnjë hamendje:

pjesë të Europës Juglindore.

Takimet diplomatike të Ushtrisë Çlirimtare Kosovës me diplomatët amerikanë dhe udhëheqësit e institucioneve

Pas takimit të Bardhyl Mahmutit me ministrin e Jashtëm holandez UÇK-ja u premtonte lëvizje të sigurt vëzhguesve në Kosovë

"Mahmuti tha se UÇK-ja do të vazhdojë të respektojë armëpushimin dhe do t'u garantojë siguri verifikuesve të OSBE-së", tha zëdhënësi i ministrit të Jashtëm pas takimit

HAGË, 11 NENTOR (REUTERS) - Ushtria Çlirimtare e Kosovës, të mërkurën, dha fjalën se do t'i përmbyset armëpushimit të ndërmjetuar nga SHBA-ja dhe do t'u mundësojë lëvizje të sigurt vëzhguesve ndërkombëtarë. Përfaqësuesi politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Bardhyl Mahmuti, dha këto garanci gjatë bisedimeve me ministrin e Jashtëm holandez, Jozias van Aartsen, njofton zëdhënësi i ministrit. "Mahmuti tha se UÇK-ja do të vazhdojë të respektojë armëpushimin dhe do t'u garantojë siguri verifikuesve të OSBE-së". Ai po ashtu tha se Qeveria e Holandës ka theksuar se Perëndimi pret pëmbushje të kërkesave të rezolutave të OKB-së nga të dyja palët në konflikt. Ndërkaq, Van Aartsen, i deklaroi delegacionit të shqiptarëve se "pavarësia e Kosovës nuk është ndonjë opcion andaj duhet të gjendet një formë e autonomisë", tha zëdhënësi. Holanda ka ofruar një aeroplan



vëzhgues dhe 30-50 vëzhgues në misionin e përbashkët ndërkombëtar që ka si detyrë të verifikojë armëpushimin në Kosovë. Mirëpo, parlamenti po kërkon garanci sigurie në mënyrë që vëzhguesit të mos bëhen pengje, siç ka ndodhur në luftën e Bosnjës, më 1992-95.

Takimet tona vazhduan në Komisionin për Politikë të Jashtme të Parlamentit Evropian, me ministrin e Jashtëm të Austrisë, z. Wolfgang Schüssel (i cili përfaqësonte pesëmbëdhjetë vendet e BE-së për arsye se në atë kohë Austria ishte kryesuese e radhës e Bashkimit Evropian). Në këtë takim z. Schüssel shoqërohej nga ambasadori i Austrisë në Beograd, z. Wolfgang Petritsch (i dërguari i posaçëm i BE-së për Kosovë) dhe nga z. Peter Hohenfellner (Drejtorin Politik në Ministrinë e Jashtme të Austrisë). Është me rëndësi për lexuesin të përmend se që në fjalët e para, ministri Schüssel e cilësoi takimin si "shumë të rëndësishëm për Bashkimin Evropian dhe për UÇK-në, sepse nuk lë asnjë dyshim rreth qëndrimit të BE-së për domosdoshmërinë e përfshirjes së UÇK-së në bisedime për ardhmërinë politike të Kosovës." Në këtë takim dhe në takimet që patëm me ministrin e Jashtëm i Holandës, z. Jozias van Aartsen, me anëtarët e Komisionit për Politikë të Jashtme të Parlamentit të Holandës, dhe me sekretarin e Shtetit në Ministrinë e Jashtme të Gjermanisë, z. Wolfgang Ischinger dhe zv. Drejtorin dhe zëdhënësin e MPJ të RFGJ, z. Martin Erdmann, ne kërkuaam që ta përkrahin luftën tonë të drejtë dhe kërkesën legjitime të popullit shqiptar për pavarësinë e Kosovës, si zgjidhje e vetme për një paqe të qëndrueshme në këtë

kryesore të BE-së dëshmonin për legjitimitetin që kishte fituar lufta jonë dhe vetëdijësimin i akterëve me peshë në marrëdhëniet ndërkombëtare për domosdoshmërinë e përfshirjes së përfaqësuesve të UÇK-së në procesin e zgjidhjes politike përfundimtare të çështjes së Kosovës. Të vetëdijshëm se përfaqësuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk do të bënin asnjë kompromis që do të ishte në kundërshtim me vullnetin politik të popullit shqiptar, regjimi i Slllobodan Millosheviqit vuri në lëvizje të gjitha mekanizmat që ta prezantonte UÇK-në si "organizatë terroriste" dhe t'ia pamundësoonte përfshirjen e saj në bisedimet për ardhmërinë politike të Kosovës. Në këtë kontekst duhet të shihet edhe vendimi për intensifikimin e vrasjeve të civilëve serbë dhe malazezë dhe propaganda që këto vrasje t'i visheshin UÇK-së.

"Epoka e re": Në deklaratën politike nr. 21, të publikuar tri ditë pas krimit në kafenenë "Panda", UÇK-ja sqaronte opinionin publik se as nuk e kishte kryer dhe as nuk kishte nxitur vrasjen e të rinjve serbë, dhe shprehu bindjen se prapa këtij krimi mizor qëndronte Shërbimi Sekret i Serbisë. Pesëmbëdhjetë vjet pas kësaj ngjarjeje tragjike, doli e saktë bindja që kishit shprehur në atë kohë. Personalitete të skenës

Delegacioni i shqiptarëve të Kosovës në Parlamentin Evropian në Bruksel

UÇK-ja, për herë të parë, shpreh platformën e saj para Parlamentit Evropian

- Doris Pack: "UÇK-ja ka lindur si pasojë e aparteidit dhjetëvjeçar në Kosovë dhe për këtë mbajmë përgjegjësi edhe ne, edhe Amerika"
- Bardhyl Mahmuti: "Ju të nderuar deputetë të këtij Parlamenti, apo prindërit tuaj, nuk keni pritur demokratizimin e Gjermanisë nazifashiste gjatë Luftës së Dytë Botërore, por keni rrokur armët për t'u çliruar kështuqë këtë të drejtë nuk mund të na mohoni as neve"

politike të Serbisë, si Vuk Drashković, Aleksandar Vučić e të tjerë, pohuan publikisht se krimi në kafenenë "Panda" ishte kryer me urdhër të Sllobodan Millosheviqit dhe ishte ekzekutuar nga Shërbimi Sekret i Serbisë. Megjithatë ka njerëz që edhe sot e kësaj dite nuk e dinë të vërtetën e kësaj tragjedie.

Bardhyl Mahmuti: Më lejoni të sqaroj për lexuesit që nuk e dinë përfundimin e tmerreve që përjetuan Behar Bajri, Vllaznim Përgjegjaj, Gazmend Bajrami, Xhevdet Bajrami, Agron Kollçaku dhe Beqir Loxhaj të cilët hetuesia millosheviqiane i detyroi ta pranonin fajësinë për kryerjen e këtij krimi dhe për vrasjen e shumë policëve. Pas dhjetë muaj torturash mizore dhe dhune të të gjitha formave, më 18 tetor 1999, në Gjykatën e Qarkut të Leskovcit, filloi gjykimi kundër tyre. Që në hapje të procesit gjyqësor të gjithë të akuzuarit hodhën poshtë akuzat dhe u deklaruan të pafajshëm. Ata sqaruan se kishin qenë të detyruar të nënshkruanin deklaratat me të cilat pohonin vrasjet e lartpërmendura dhe se realisht nuk kishin qenë pjesëmarrës në asnjë vrasje. Të akuzuarit zhveshën këmbësor në prani të atyre që ishin në sallën e gjykatës dhe treguan shenjat e plagëve nga torturat. Shenjat e prerjeve me thika dhe djegieve me zjarr, si në kohën e inkuizicionit, i tmerruan të pranishmit në sallën e Gjykatës së Qarkut në Leskovc. Përballë kësaj situatë të paparashikuar, gjykatësi ndërpreu gjykimin. Tri javë më vonë, më 9 nëntor 1999, rifilloi procesi gjyqësor. Prokurori i njoftoi të akuzuarit se ishin liruar nga akuza për vrasjen e gjashtë të rinjve serbë dhe malazezë në kafenenë "Panda". Për të mos i liruar si të pafajshëm, gjashtë të rinjtë shqiptarë u dënuan me nga një vjet burg si anëtarë të "grupit terrorist Bombaši" dhe si "pjesëtarë të UÇK-së që kishin vrarë shumë policë në fshatrat Prilep dhe Carrabreg të komunës së Deçanit".

Siç e përmendët edhe ju, pesëmbëdhjetë vjet pas vrasjes në kafenenë "Panda", Zëvendëskryeministri i Jugosllavisë dhe përgjegjësi për politikë të jashtme të këtij shteti gjatë luftës në Kosovë, Vuk Drashković, bëri publike se "në atë kohë, Shtabi Strategjik i Millosheviqit kishte vendosur që Shërbimi i Sigurisë Shtetërore të ndërmerre sulme terroriste kundër civilëve serbë, shqiptarë dhe të përkatësive të tjera etnike, të cilat duhej t'i visheshin UÇK-së. Nëpërmjet kësaj strategjie synoheshin dy qëllime: 1. Në sytë e opinionit publik ndërkombëtar, UÇK-ja të prezantohej si organizatë terroriste dhe 2. T'u jepej zjarr ndjenjave antishqiptare në Kosovë dhe në tërë Serbinë.

Në funksion të kësaj strategjie, Sigurimi Shtetëror i Serbisë, në krye me Radomir Markoviqin, me

ndihmën e Milorad Ulemek-Legijas, më 14 dhjetor 1998 kreu masakrën kundër gjashtë djelmohave serbë në kafenenë "Panda" në Pejë".

kërkohej "të merreshin aksione efikase për shkatërrimin e terrorizmit shqiptar". Ndërkaq në rrafshin ndërkombëtar, Serbia shfrytëzoi të gjitha kanalet

diplomatët, historianët, juristët dhe gazetarët shqiptarë të Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë për identitetin e personave që përmenden në numrat rendorë 36-41 të listës së "civilëve serbë të vrarë", vrasja e të cilëve i atribuohet UÇK-së, mund të jenë të rrallë ata që e dinë se Ivan Obradovi (14 vjeç), Dragan Trifovi (16 vjeç), Vukota Gvozdenovi (16 vjeç), Svetislav Risti (16 vjeç), Zoran Stanojevi (16 vjeç) dhe Ivan Radevi (27 vjeç) janë të rinjtë serbë e malazezë që u vranë nga Shërbimi Sekret i Serbisë në kafenenë "Panda".

Imagjioni çfarë përshtypjeje kanë mundur të krijojnë politikanët, parlamentarët, diplomatët, historianët, juristët, gazetarët amerikanë, anglezë, francezë apo të cilësdo përkatësi kombëtare qofshin të cilët gjatë studimeve të veta kanë lexuar tekste të tilla që shtrembërojnë tërësisht të vërtetën! Nuk kemi ardhur rastësisht në pozitën që jemi sot!

"Epoka e re": Për dallim nga shumica e veprave të autorëve shqiptarë të Kosovës (Rexhep Qosja, Jakup Krasniqi, Ramë Buja etj.) që kanë trajtuar aspekte të ndryshme të luftës në Kosovë dhe të paqes së përgjakshme, veprat e të cilëve nuk u përkthyen në gjuhë të huaja, vepra juaj "Mashtrimi i madh" është përkthyer dhe botuar në gjuhën angleze dhe atë frënge. Mirëpo, përpara disa vitesh, opinioni publik në Kosovë u njoftua se një numër i madh i ekzemplarëve të librit në gjuhën angleze, të cilat i ishin dhënë falas Ministrisë së

Punëve të Jashtme të Kosovës, ishin futur në depo të kësaj ministrie.

Bardhyl Mahmuti: Është e vërtetë se falë angazhimit të jashtëzakonshëm të një numri veprimtarësh të kauzës kombëtare, ku do ta veçoja Ramadan Avdiun, Agush Bujën, Adnan Asllanin dhe Isuf Sherifin, libri u përkthye në disa gjuhë të botës. Mbi 1000 ekzemplarë të librit në gjuhën angleze iu dhanë falas MPJ të Kosovës. Nga ky kontingjent librash disa diplomatë (ku veçohen Ramadan Avdiu, Arjan Kashtanaj dhe Sabri Kijçari), deputetë të Kuvendit të Kosovës (sidomos Elmi Reçica dhe Bilall Sherifi) në kontakte me politikanë dhe diplomatë të huaj ua kanë dhuruar versionin në gjuhën angleze të veprës "Mashtrimi i madh". Përveç shpërndarjes në qarqe diplomatike dhe bartës të institucioneve politike ndërkombëtare, libri u është dhuruar njerëzve me influencë dhe bibliotekave universitare nga profesori i Universitetit të Prizrenit, Shkëlqim Millaku, veprimtari politik në Gjermani Ilir Seferi, nga Ibrahim Xhemajli dhe Ixhet Lutfiu në Danimarkë, Iris Hoxha në ShBA etj. Megjithatë, se në depot e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës ishin dërguar një numër i caktuar i librit në gjuhën angleze. Pa marrë parasysh kush e ka bërë një gjë të tillë, fshehja e librit është në funksion të fshehjes së gjenocidit të Serbisë ndaj shqiptarëve në Kosovë.

(Muhamet MAVRAJ / Vizion)




Jo vetëm në kohën kur ndodhi ky krim, por në vazhdimësi jemi përpjekur të sqarojmë se në asnjë rast civilët nuk kanë qenë objekt sulmi i UÇK-së. Nëse analizojmë objektivisht efektet e propagandës shtetërore serbe, do të bindemi se në rrafshin e brendshëm kjo propagandë realizoi tërësisht qëllimin për ta nxitur urrejtjen antishqiptare: Mësimi u ndërpre në të gjitha nivelet e arsimit, nga shkollat fillore e deri tek universitetet, dhe në katër anët e Serbisë u organizuan protesta në të cilën

diplomatike të trashëguara nga procesi i shpërbërjes së Federatës së Jugosllavisë dhe nuk la institucion politik ose bibliotekë universitare në botë pa i dërguar "librat e bardhë" që kishte përpiluar me qëllim të nxinin luftën tonë çlirimtare. Kjo qasje ka dhënë rezultatet e veta dhe jo rastësisht në qarqe të caktuara politike dhe intelektuale ndërkombëtare ka të tillë që i besuan vërtetësisë së sajësive të Shërbimit Sekret serb.

Kam bindjen e plotë se nëse pyesim politikanët, deputetët,

Fshehja e të vërtetës për krimet serbe në depot e MPJ të Kosovës



Reforma fiskale në Kosovë ul varshmërinë e bizneseve ndaj kredive të bankave komerciale



Shkruan: **Safet GËRXHALIU,**
*ish-kryetar i Odës
Ekonomike të Kosovës*

Ekonomia e një shteti kërkon dialog, unitet politik dhe bashkërenditje me të gjithë akterët relevantë pa dallim përkatësie politike apo partiake, në veçanti të merren rekomandimet e profesionistëve të fushave përkatëse.

Kritikat dhe rekomandimet e ekspertëve nuk janë armiqësi, por mënyra të të mësuarit dhe të

avancimit ekonomik të Republikës së Kosovës. Parametrat ekonomikë janë shqetësues në çdo aspekt dhe ky realitet duhet të pranohet në qoftë se mendohet të ndryshohet apo përmirësohet ky shqetësim në interes të shtetit dhe qytetarëve. Sektori bankar në Kosovë ka luajtur një rol substancial në zhvillimin ekonomik. Përveç kontributit ekonomik, social, integruar, digjitalizimit dhe ndërkombëtarizimit, sektori bankar ka krijuar kuadro dhe akademi bankare të standardeve të larta ndërkombëtare. Kohëve të fundit lexohen shkrime e komente për fitime të larta të bankave komerciale në Kosovë, që është e vërtetë, por askush nuk e paraqet faktin se Kosova ka nevojë për reformë fiskale e cila do të jetë në mbështetje të sektorit privat duke ulur varshmërinë e tyre nga

bankat komerciale. Ka vite që nuk ka asnjë lëvizje në politikën tatimore në Kosovë. Tatimi i vlerës së shtuar (TVSh) në import me urgjencë duhet të ndryshohet, me qëllim që t'u mundësohet kompanive vendore që ta paguajnë TVSh-në pas një periudhe kohore, qoftë 60 ditore apo 90 ditore dhe jo menjëherë pasi të hyjë në kufi. Një hap i tillë do t'u krijonte kompanive një likuiditet shumë të madh dhe një mundësi shumë të madhe për ta rritur aktivitetin biznesor dhe për të shtuar qarkullimin. Bizneset ende në vitin 2023 janë të dënuara për të paguar tatimin e vlerës së shtuar për mallin që e importon në Kosovë ende pa e shitur te konsumatori, dhe me këtë veprim biznesi ende e krediton shtetin. Me këtë politikë biznesi detyrohet të marrë kredi dhe t'i nënshtrohet

interesave të over-drafteve dhe shpenzimeve ekstra të institucioneve financiare, në veçanti kohëve të fundit adresimi i kërkesave edhe tek institucionet mikro-financiare ku paguhen kamata edhe më të larta. Një rekomandim tjetër është që të shihet se si të reduktohet vlera e tatimit të shtuar te disa produkte që do të ndikonte në mënyrë direkte në jetën e qytetarëve në këtë kohë inflatore. Çmimet e produkteve të konsumit ditor po rriten dhe duhet zgjeruar numri i atyre produkteve dhe të ulet norma e tatimit si ndihmë për qytetarët në këtë kohë të ngritjes së çmimeve, por jo edhe pagave e pensioneve. Jemi shndërruar në shoqëri të varur nga importi dhe duhet bërë çmos në përmirësimin e bilancit të pagesave. Në këtë drejtim ndryshimet në tatimet doganore

do të ndikonin në zbutjen e inflacionit dhe rritjen e prodhimit vendor. Tatimi doganore duhet të hiqet edhe për disa produkte që marrin pjesë në procesin e prodhimit dhe finalizimit të produkteve "Made in Kosova" ose që janë pjesë përcjellëse të teknologjisë së nevojshme për prodhim apo finalizim të produkteve vendore. Këto reforma mundësojnë frymëmarrje ekonomike për bizneset vendore dhe një distancim gradual nga varshmëria e bankave komerciale të cilat po e shfrytëzojnë këtë situatë, sepse në Kosovë dominon agenda politike e për reforma fiskale e ekonomike nuk mendon askush. Është koha e fundit që ekonomia e Kosovës të jetë prioritet institucional e qeveritar dhe jo eksperiment politik që shkon në dëm të qytetarëve dhe ardhmërisë.

Kosova, një vend me potencial të jashtëzakonshëm për investime të huaja dhe ndërmarrësi



PRISHTINË, 16 TETOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, së bashku me një delegacion nga Kosova, me ftesë të ministrit të Shtetit për Tregti të Jashtëm të Emirateve të Bashkuara Arabe, Sh. T. Dr. Thani bin Ahmed Al Zeyoudi, është duke marrë pjesë

në "Forum Botëror për Investime", i cili po mbahet në Abu Dhabi. Ministria Hajdari, në takimet e zhvilluara me homologë nga vendet e ndryshme të botës, përmendi mundësitë dhe potencialin e madh që ka Republika e Kosovës për

investimet e huaja dhe ndërmarrësi, duke theksuar se, përkundër sfidave, Kosova ka shënuar trend pozitiv të rritjes ekonomike. Ajo ka potencuar se përgjatë dy viteve të fundit Kosova ka shënuar përparim të madh në klimën e të bërit biznes, gjë që ka ndikuar edhe

në rritjen e interesimit për investimet e huaja. Ministria Hajdari ftoi homologët për vizitë në Kosovë, për ta parë mjedisin e të bërit biznesit dhe mundësitë e shumta që mund të shfrytëzohen, duke u zotuar se investitorët e huaj do të gjejnë mbështetje të plotë

institucionale. Ky është edicioni i tetë i Forumit Botëror për Investime që mbahet çdo dy vjet, ndërsa bën bashkë zyrtarë të lartë të shtetit të mbi 160 vendeve, duke përfshirë edhe investitorë potencialë dhe liderë të ndërmarrësisë.

Qeveria emëron kryesuesin e Bordit të Korporatës Energjetike të Kosovës

PRISHTINË, 16 TETOR - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e fundit, e cila është mbajtur në mënyrë elektronike, ka marrë vendim për emërimin e kryesuesit të Bordit të Korporatës Energjetike të Kosovës dhe dy vendime për shpronësim të pronave. Në njoftimin për medie thuhet se qeveria ka ndryshuar dhe

plotësuar vendimin e qeverisë nr. 02/58 të datës 2 shkurt 2022 për emërimin e Bordit të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Korporata Energjetike e Kosovës" duke emëruar Artan Ahmetin kryesues dhe Skender Hazirin anëtar të bordit. Gjithashtu, në këtë mbledhje qeveria ka miratuar vendimin për shpronësim të pronave të

paluajtshme të cilat preken nga realizimi i projektit: "Zgjerimi i rrugës rajonale R 115 Prizren - Prevallë" dhe vendimi për shpronësim të pronave të paluajtshme të cilat preken nga realizimi i projektit "Zgjerimi i rrugës rajonale R 115 Doganaj - Shtërpcë", zonat kadastrale Viqë dhe Drekok, komuna Shtërpcë.



Kjo është historia e vërtetë e frimasonëve



Çfarë kanë të përbashkët Rev. Jesse Jackson, George Washington, Wolfgang Amadeus Mozart, Duke Ellington dhe Buzz Aldrin? Të gjithë janë anëtarë të shoqërisë më të madhe sekrete në botë, Frimasonët – një grup anëtarët e të cilit përfshijnë disa nga njerëzit më me ndikim në botë dhe ritualet e fshehta të të cilit kanë vazhduar me shekuj. Kush merret me teori konspirative spekulon se grupi tërheq fijet e pushtetit dhe financave ndërkombëtare dhe është përgjegjës për vrasjet e profilit të lartë – disa madje pretendojnë se anëtarët e tij adhurojnë Satanën. Ku është kufiri midis faktit dhe sajësës, brenda kësaj shoqërie të fshehtë?

shekullin e 18-të, një sërë grupesh burrash të emërtuar sipas pub-eve angleze në të cilat takoheshin, u bashkuan në atë që ata e quajtën “Grand Lodge”, një shoqatë që mblidhej për të mbajtur rituale dhe ceremoni dhe futur anëtarë të rinj. E njohur sot si Lozha e Madhe Premier e Anglisë, grupi ishte i pari i llojit të tij, dhe ndërsa anëtarësia u zgjerua, lista e ritualeve dhe ceremonive sekrete dhe kërkesat e anëtarësimit u shtuan. Sipas Shoqatës së Shërbimit Masonik të Amerikës së Veriut, kishte rreth 898,000 Frimasonë në SHBA që nga viti 2020, dhe ka rreth 6 milionë masonë në mbarë botën.

Kush mund të bëhet frimason?

Sot, kërkesat për anëtarësim janë relativisht të thjeshta: Megjithëse çdo grup, ose Lozhë, e Frimasonëve ka rregullat e veta, në përgjithësi një Frimason duhet të jetë mashkull që rekomandohet nga anëtarët e tjerë të Lozhës, të besojë në një “Qenie Supreme”, të ketë karakter të mirë moral dhe të zotohet të mësojë mënyrat e vëllazërisë bashkë me zakonet e lashta. Këto zakone përfshijnë një hierarki të rreptë dhe një shumëllojshmëri ceremonish dhe ritualesh. Pasi inicohen në lozhën e tyre, anëtarët kalojnë nëpër një sërë “gradash” anëtarësie, duke u ngritur nga Entered Apprentice në Fellowcraft në Master Mason. Gjatë rrugës, ata mësojnë gjuhën, ritet dhe besimet e “zanatit”, duke u përfshirë në rituale që i përkasin besimeve biblike. Ata gjithashtu miratojnë emblema që variojnë nga katrori dhe busulla, që përfaqëson moralin, kosherja e bletëve, e cila thuhet se përfaqëson bashkëpunimin dhe punën ndërmjet anëtarëve, dhe “Syri i Providencës” ose “Syri që sheh gjithçka”, që

përfaqëson vigjilencën e përditshme të Zotit. Disa nga këto simbole janë aq të njohura – për shembull, Syri i Providencës mund të gjendet në kartëmonedhat e një dollarëshit amerikan.

Pse katolicizmi e ndalon masonerinë?


Kur ata nuk mbajnë ritualet e hollësishme të anëtarësimit, masonët shpesh angazhohen në shërbime komunitare dhe filantropi, ofrojnë mbështetje të ndërsjellë për anëtarët ose punojnë me organizata të lidhura. Por përkundër këtij fokusi bamirës dhe faktit që nuk është një fe formale, Masoneria nuk është e pranuar botërisht. Në fakt, Masoneria është e ndaluar nga Katolicizmi, i cili i ndalon katolikët të bashkohen dhe i inkurajon të shoqërohen me organizata katolike si Kalorësit

e Kolombit. “Parimet e tyre janë konsideruar gjithmonë të padëshirueshme nga doktrina e Kishës dhe prandaj anëtarësimi në to mbetet i ndaluar,” deklaroi Kisha në vitin 1983. “Besimtarët që regjistrohen në shoqatat masonike janë në një gjendje mëkati të rëndë dhe mund të mos marrin Kungimin e Shenjtë.” Siç shpjegon Ed Condon i Catholic Herald, Kisha e kundërshton masonerinë për shkak të fokusit të saj laik dhe rolit të saj si një vend i shenjtë për “ata me ide dhe axhenda heterodokse”.

Pushtet dhe panik


Ato axhenda kanë nxitur prej kohësh polemika për shkak të fuqisë politike të zotëruar nga disa masonë. Megjithëse rregullat e shumicës së lozhave i dekurajojnë anëtarët që të diskutojnë politikë, shumë nga anëtarët e saj janë aktivë në parti politike dhe qeveri. Fshehtësia e organizatës dhe betimet e vëllazërisë kanë shkaktuar teori konspirative rreth agjendave politike të anëtarëve të saj. Shumica e teorive konspirative spekulojnë se të gjithë masonët kanë të njëjtat besime dhe veprojnë si një trup, duke u lidhur me teoritë konspirative moderne antisemite që e lidhin grupin me një “Rend të Ri Botëror” të dyshimtë, që kontrollojnë financat dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Si rezultat, Masoneria është bërë

ikonë në kulturën popullore dhe në mesin e jo-anëtarëve që janë të intriguar nga ritualet e saj të dyshimta. Megjithatë anëtarësimi është zvogëluar për vite me rradhë. Pse kjo rënie? Disa e lidhin me një prirje më të madhe midis organizatave vëllazërore dhe klubeve të shërbimit si Urdhëri Mirëdashës dhe Mbrojtës i Elksit, të cilët kanë parë rënie të mëdha gjatë dekadave. Të tjerë ia atribuojnë rënien e anëtarësimit refuzimit të lëvizjes për të pranuar gratë, pavarësisht ekzistencës së disa lozhave tërësisht femra. Ose ndoshta rënia është për shkak të rritjes së ndërgjegjësimit publik për ritualet dikur sekrete të lëvizjes, thotë historiani John Dickie. “Unë mendoj se ndoshta çështja është se fshehtësia ka humbur diçka nga magjia e saj,” tha Dickie. Jetojmë në epokën kur mund të duhen dy minuta ose më pak në Google për të zbuluar se cilat janë në të vërtetë sekretet e masonëve. Pavarësisht polemikave dhe dënimeve, lëvizja vazhdon – por vetëm koha mund të tregojë nëse masoneria do të mbetet e rëndësishme në shekullin e 21-të. Ndërkohë, anëtarët e saj thonë se e shohin masonerinë si gjithçka, nga një vëllazëri e fuqishme deri te një shans për t’i kthyer komunitetit, në atë që një anëtar anglez e quan “një rrugë për rritje dhe zhvillim personal”. Tani për tani, ritualet dhe simbolet e fshehta të Masonerisë jetojnë – së bashku me ndikimin e anëtarëve të saj më të njohur. / NG – Bota.al



Origjina

Megjithëse lëvizja e Masonerisë i ka rrënjët në repartet mesjetare të gurgdhendësve, shumica dërrmuese e anëtarëve të lëvizjes nuk janë mjeshtrë të punimit të gurit. Besohet se ndërsa anëtarësimi i gurgdhendësve u zvogëluar, grupi filloi të pranonte anëtarë ndëri për të forcuar numrin e tyre. Mishërimi modern i masonerisë daton në Epokën e Iluminizmit të shekullit të 18-të, kur anglezët e arsimuar synonin të komunikonin me të tjerët dhe të diskutonin çështje të filozofisë, fesë dhe jetës në një mjedis të organizuar. Organizatat vëllazërore kishin ekzistuar me shekuj, por në



Vdes Martti Ahtisaari

Prishtinë, 16 tetor - Ish-presidenti i Finlandës, Martti Ahtisaari, ka vdekur në moshën 86-vjeçare në Helsink, njoftoi Presidenca finlandeze. Ahtisaari ka qenë i dërguar i posaçëm i Kombeve të Bashkuara për Kosovën, i ngarkuar për organizimin e negociatave të procesit të statusit të Kosovës. Mbi planin që ai hartoi, u shpall edhe pavarësia e Kosovës më 17 shkurt 2008.

Ai u shpërblye me Çmimin Nobel për Paqe më 2008 për shkak të kontributit të tij për dhënien fund të konflikteve edhe në Indonezi, Namibi apo Irlandën Veriore.

Ahtisaari kishte refuzuar të pranonte se luftërat dhe konfliktet ishin të pashmangshme. "Paqja është çështje e vullnetit. Të gjitha konfliktet mund të zgjidhen dhe nuk ka asnjë justifikim që t'i lejojmë që ato të bëhen të

përrjetshme", kishte deklaruar Ahtisaari gjatë pranimit të Nobelit më 2008.

Ahtisaari ishte tërhequr nga jeta publike dhe politike më 2021, pasi u diagnostikua me sëmundjen e Allzajmerit.

Ai ishte president i Finlandës nga viti 1994 deri më 2000.

Ngushëllime familjes dhe shtetit të Finlandës i kanë shprehur përfaqësues të institucioneve të Kosovës dhe liderë të opozitës.



Parlamenti Evropian do të kërkojë masa ndëshkuese ndaj Serbisë

PRISHTINË, 16 TETOR - Grupet politike në Parlamentin Evropian (PE) janë duke formuluar propozimet e tyre për një rezolutë të posaçme për zhvillimet në Kosovë dhe për raportet në mes të Prishtinës dhe Beogradit.

Burimet brenda PE-së i kanë thënë "Radios Evropa e Lirë" se në bazë të asaj që është deklaruar në një diskutim për situatën në Kosovë para dy javësh, mund të pritet që në këtë rezolutë të bëhet ftesë për Kosovën dhe Serbinë që t'i kthehen dialogut të ndërmjetësuar nga Brukseli, por edhe do të kërkohen masa ndëshkuese ndaj Serbisë.

Sa i përket vendosjes së masave ndaj Serbisë ka pajtim të shumicës në PE, thanë burimet, por vendimet në këtë drejtim i merr Këshilli i BE-së në rast se bëhet fjalë për sanksione klasike, apo Komisioni Evropian që ka kompetenca të vendosë masa ndëshkuese, ashtu siç tashmë ka



vendosur ndaj Kosovës.

Kjo rezolutë do të vendoset në procedurë të përshpejtuar dhe

pritet të miratohet më 19 tetor gjatë seancës plenare të PE-së. Sipas burimeve, përmes

rezolutës pritet të kërkohet hetimi i plotë për sulmin ndaj Policisë së Kosovës më 24 shtator

në fshatin Banjskë të Zveçanit.

Kosova ka fajësuar Serbinë për sulmin e grupit të armatosur të serbëve ndaj Policisë së Kosovës, që la të vranë policin Afrim Bunjaku. Serbia ka mohuar se ka gisht në këtë ngjarje.

Më herët BE-ja ka thënë se po pret përfundimin e hetimeve dhe më pas do të ndërmarrë hapa dhe masa të mundshme.

Idea për një rezolutë të tillë në PE është paraqitur nga deputeti socialdemokrat nga Kroacia, Tonino Piculla, dhe ka marrë mbështetjen e nevojshme nga grupet politike.

Tani pritet që secili grup politik ta paraqesë draftin e vet për rezolutë. Pas kësaj, do të caktohet një udhëheqës i cili do të koordinojë arritjen e një kompromisi për amendamentet e rezolutës. Kur grupet ta arrijnë pajtimin për tekstin e përbashkët të rezolutës, atëherë do të hidhet në votim në seancën plenare të PE-së.

Nga janari 74 raste të dhunës seksuale, Haxhiu: Numri i madh është kampioni alarmi për institucionet



PRISHTINË, 16 TETOR - Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) ka lansuar projektin "Rehabilitimi dhe riintegrimi i të miturve - viktimat e dhunës seksuale".

Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, me këtë rast tha se kanë ndërmarrë një varg reformash ligjore që adresojnë këtë çështje. Por, sipas saj, shqetësuese mbetet

fakti i rritjes së vazhdueshëm të numrit të rasteve, ku është konfirmuar se nga janari janë ekzaminuar në Institutin e Mjekësisë Ligjore 74 raste të dhunës seksuale.

Ky numër kaq i madh i rasteve, sidomos te të miturit, sipas ministres, është kampioni alarmi për të gjitha institucionet që të bashkëpunojnë e të ndërmarrin masa. "Për fat të keq, të dhënat e

fundit në Kosovë tregojnë për një rritje të rasteve të dhunës seksuale nëse marrim statistikën nga janari deri në shtator të këtij viti ku janë 74 raste të ekzaminuara në Institutin e Mjekësisë Ligjore. Të dhënat tregojnë një numër në rritje të konsiderueshme të fëmijëve që janë të mbijetuar të kësaj dhune krahasuar me numrin e të rriturve", ka thënë Haxhiu.

KFOR-i me Policinë e Kosovës patrullojnë për sigurinë e kufijve

Prishtinë, 16 tetor - Ushtarët e KFOR-it kanë mbajtur patrullime bashkë me Policinë e Kosovës. Sipas njoftimit të misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, patrullimet u zhvilluan nga Komanda Rajonale West (RC-W), brenda zonës së tyre të

përgjegjësisë, me qëllim të monitorimit të territorit dhe sigurimit të një kornize adekuate të sigurisë. "KFOR-i është gjithmonë i përkushtuar për ta mbështetur paqen, bashkëpunimin dhe përparimin për të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë,

sipas mandatit të saj, bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të vitit 1999, duke kontribuar në mirëmbajtjen e një Mjedisi të Sigurt dhe Lirinë e Lëvizjes për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë", thuhet në njoftimin e KFOR-it.



Kur muzika bashkon izraelitët dhe palestinezët



Nga: **Daniel BARENBOIM**, pianist dhe dirigjent / *The Guardian* (titulli original: *In our orchestra, Israelis and Palestinians found common ground. Our hearts are broken by this conflict*)
Përkthimi: Agron **SHALA** / *Telegrafi.com*

Muzika është njëra mënyrë për t'i bashkuar njerëzit – të gjithë në jemi qenie të barabarta njerëzore që meritojmë paqen, lirinë dhe lumturinë.

Të gjithë neve na kanë tronditur thellë ngjarjet në Izrael dhe në Gaza. Nuk ka asnjë justifikim për aktet barbare terroriste të Hamasit kundër civilëve, përfshirë fëmijët dhe foshnjat. Duhet ta pranojmë këtë dhe ta ndalojmë. Dhe, duhet t'i bëjmë thirrje Izraelit të respektojë ligjin ndërkombëtar teksa po përgatitet për të pushtuar Gazën. Por, hapi tjetër është të shtrojmë pyetjen: çfarë tash? A i dorëzohemi kësaj dhune të tmerrshme dhe a lejojmë të vdesin përpjekjet tona për paqen – apo këmbëngulim se duhet dhe mund të ketë paqe? Jam i bindur se duhet të ecim përpara dhe ta kemi parasysh kontekstin më të gjerë të konfliktit.

Në vitin 1999, me mikun tim Eduard Said e formova Orkestrën e Divanit Perëndim-Lindje [West-Eastern Divan Orchestra], në

mënyrë që muzikantë e rinj nga gjithë Lindja e Mesme të mund të mblidheshin, të flisnin dhe të interpretonin së bashku. Sot, muzikantët tanë në Divanin Perëndim-Lindje dhe studentët tanë në Akademinë "Barenboim-Said", pothuajse të gjithë janë drejtpërdrejt të prekur nga konflikti. Shumë prej muzikantëve jetojnë në rajon, ndërsa të tjerët kanë shumë lidhje me vendlindjen. Kjo ma forcon bindjen se mund të ketë vetëm një zgjidhje për këtë konflikt: zgjidhje të bazuar në humanizëm, në drejtësi dhe në barazi, dhe pa forca të armatosura dhe pa okupim.

Mesazhi ynë i paqes duhet të jetë më i zëshëm se kurrë. Rreziku më i madh është se të gjithë njerëzit që me aq zell e duan paqen, do të mbyten nga ekstremistët dhe nga dhuna. Por, çdo analizë, çdo ekuacion moral që mund ta hartojmë, në thelb duhet të ketë këtë kuptim bazik: ka njerëz në të dyja anët. Njerëzimi është universal dhe njohja e kësaj të vërtete është e vetmja rrugë. Vuajtjet e njerëzve të pafajshëm, në të dyja anët, janë absolutisht të padurueshme.

Zemrat tona thyhen nga pamjet e sulmeve terroriste shkatërruese nga Hamasit. Ky impuls është thelbësor për të empatizuar gjendjen e të tjerëve. Sigurisht,

dhe veçanërisht tani, duhet të lejohen edhe emocione e tilla si frika, dëshpërimi dhe zemërimi – por, në momentin që kjo na bën t'ia mohojmë njëri-tjetrit njerëzimin, ne veçse jemi të humbur. Çdo person i vetëm mund ta bëjë një ndryshim dhe të ofrojë diçka. Kështu, në një shkallë të vogël i ndryshojmë gjërat. E, në shkallë më të gjerë – kjo varet nga politika.

Duhet të ofrojmë perspektiva të tjera për ata që tërhiqen nga ekstremizmi. Në fund të fundit, ata që gjejnë vend aty zakonisht janë njerëz pa kurrfarë perspektive, të dëshpëruar, që i përkushtohen ideologjive vrastare. Edukimi dhe informacioni janë po aq thelbësorë, sepse ka kaq shumë gjëra të bazuara krejtësisht në dezinformata.

Për të përsëritur më qartë: konflikti izraelito-palëstinez nuk është konflikt politik mes dy shteteve për kufijtë, për ujën, për naftën apo për burimet e tjera. Në thelb është konflikt njerëzor mes dy popujve që kanë njohur vuajtjet dhe persekutimet. Persekutimi i popullit hebraik gjatë 20 shekujve, kulmin e arriti me ideologjinë naziste që vrau gjashtë milionë hebrej.

Populli hebraik kishte një ëndërr: një tokë të veten, një atdhe për të gjithë hebrejtë. Por, nga kjo

ëndërr erdhi supozimi thellësisht problematik – sepse, në thelb ishte i rremë: një tokë pa popull për një popull pa tokë. Në realitet, popullsia hebraike e Palestinës ishte vetëm tetë përqind në fund të Luftës së Parë Botërore. Prandaj, 92 përqindëshi i popullsisë nuk ishin hebrej, por palestinezë – një popullsi kjo e rritur përgjatë shekujve. Vendi vështirë se mund të quhej "tokë pa popull" dhe popullsia palestineze nuk shihte asnjë arsye për të hequr dorë nga toka e vet. Kështu, konflikti ishte i pashmangshëm dhe frontet vetëm sa janë ngurtësuar për më tej përgjatë brezave. Jam i bindur se izraelitët do të kenë siguri kur palestinezët do të kenë shpresë – pra, drejtësi. Të dyja palët duhet t'i njohin armiqtë e vet si qenie njerëzore dhe të përpiqen të bashkohen me këndvështrimin e tyre, me dhimbjen dhe vështirësitë e tyre. Izraelitët duhet gjithashtu të pranojnë se pushtimi i Palestinës është i papajtuësëm me këtë.

Për ta kuptuar këtë konflikt mbi 70-vjeçar, kryesorja ka qenë miqësia ime me Saidin. Te njëri-tjetri e gjetëm homologun që mund të na shpinte tutje, të na ndihmonte që ta shohim më qartë tjetrin dhe ta kuptojmë atë më mirë. E njohëm dhe e gjetëm njëri-tjetrin në njerëzimin tonë të përbashkët. Për mua, puna jonë e përbashkët me Divanin Perëndim-Lindje, që

vazhdimin logjik dhe ndoshta edhe kulmimin e ka te Akademia "Barenboim-Said", mbase është aktiviteti më i rëndësishëm i jetës sime.

Në situatën aktuale, natyrshëm pyes veten për rëndësinë e punës sonë të përbashkët në orkestër dhe në akademi. Mund të duket e paktë – por, vlerë të jashtëzakonshme ka fakti i thjeshtë se muzikantët arabë dhe izraelitë ndajnë podiumin e përbashkët në çdo koncert dhe se së bashku bëjnë muzikë. Me kalimin e viteve, përmes kësaj të përbashkëte të krijimit të muzikës, por edhe përmes diskutimeve tona të panumërta, e ndonjëherë të nxehta, kemi mësuar ta kuptojmë më mirë tjetrin, t'i afrohem dhe ta gjejmë gjuhën e përbashkët. I fillojmë dhe i përfundojmë të gjitha debatet, sado kontroverse, me kuptimin themelor se të gjithë jemi qenie të barabarta njerëzore që meritojmë paqen, lirinë dhe lumturinë.

Kjo mund të tingëllojë si diçka naive, por nuk është: sepse, ky mirëkuptim duket se plotësisht ka humbur në konfliktin e të dyja palëve sot. Përvoja jonë tregon se ky mesazh ka arritur te shumë njerëz në rajon dhe në mbarë botën. Ne duhet, duam dhe do të vazhdojmë të besojmë në njerëzimin tonë të përbashkët. Muzika është mënyra për të na afruar më shumë. /Telegrafi/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adri: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Gjyqtarët nga Kosova do ta ndajnë drejtësinë në ndeshjen Slloveni U21 - Austri U21

Prishtinë, 16 tetor - Gjyqtarët nga Kosova vazhdojnë të paraqiten në skenën ndërkombëtare. Përveç treshes së gjyqtarëve që do ta ndajnë drejtësinë

në ndeshjen miqësore Shqipëri - Bullgari, UEFA për këtë javë ka deleguar edhe një katërshe të gjyqtarëve nga Kosova në ndeshjen Slloveni - Austri,

të grupmoshës deri 21 vjeç për Grupin G në kualifikimet e Kampionatit Evropian. Kjo ndeshje do të zhvillohet sot (e martë) në Murska Sobota. Do të jetë

Visar Kastrati gjyqtar kryesor, derisa atij do t'i asistojnë Besnik Morina dhe Arbnor Bullatovci. Gjyqtar i katërt do të jetë Alban Shala.



"Euro 2024", Jasir Asani: Plisi na forcoi zemrën për në Berlin


TIRANË, 16 TETOR - Jasir Asani është padyshim një nga futbollistët më të mirë dhe më vendimtar në ndeshjet kualifikuese të Kombëtares shqiptare që është afër kualifikimit në Kampionatin Evropian 2024.

Futbollisti shqiptar nga Shkupi shënoi një tjetër supergol me fanellën kuqezi, të enjten e kaluar kundër Çekisë në stadiumin "Air Albania" në Tiranë.

Publikimet në rrjetet sociale në lidhje me Shqipërinë janë bërë tanimë të përditshme

nga Asani. Së fundmi ai ka publikuar një fotografi të tij me plis në kokë gjatë festës së golit kundër Çekisë. "Ky plis na forcoi zemrën për Berlin", ka shkruar ylli i Kombëtares së Shqipërisë. Shqipëria është e para në Grupin E me 13 pikë, dy më shumë se Çekia dhe tri më shumë se Polonia.

Kuqezinjtë u nevojitet vetëm një pikë në dy ndeshjet e ardhshme kundër Moldavisë në udhëtim dhe Ishujve Faroe në shtëpi për ta siguruar kualifikimin në "Euro 2024".



Justin Davis, MVP i javës në Superligën e basketbollit



PRISHTINË, 16 TETOR - Peja vazhdon të jetë e pamposhtur në elitën e basketbollit, njëherësh skuadra e vetme në Superligë pa humbje. Verdhezinjtë në këtë xhiro kanë mundur Golden Eagle Yllin, ku në derbi lojtari më i dalluar ishte Justin Davis i Pejës. Davisi e ka mbyllur ndeshjen me dyshifrorë të dyfishtë, 27 pikë e dhjetë kërcime, duke e pasur indeksin e ndeshjes 26 apo më të lartën në këtë sfidë

dhe duke u shpallur MVP i javës së katërt, që është hera e parë për të në këtë edicion që shpallet MVP.

Ndërkohë, derbin e qytetit e ka fituar Bashkimi kundër Proton Cable Prizrenit, ku u dalluan Grant Lozoya dhe Erik Copes. Lozoya e ka mbyllur ndeshjen me 21 pikë, nëntë kërcime e tetë asistime, kurse qendra Copes kishte dyshifror të 'çmendur' me 25 pikë e 22 kërcime. Sigal Prishtina ka vazhduar me

fitore, duke mposhtur Istogun, ndërsa organizatori amerikan Derrick Wilson ishte më i miri i ndeshjes me 19 pikë, 12 kërcime e gjashtë asistime.

Trepça është rikthyer te fitoret, ndërsa qendra e Kosovës, Dardan Kapiti, edhe pse ka luajtur 16 minuta, ka zhvilluar një ndeshje shumë të mirë me 13 pikë, gjashtë kërcime dhe një asistim, apo duke pasur indeksin e ndeshjes në 20, më të lartën në këtë përballje.

Rrahmani rikthehet nga lëndimi, i gatshëm në fundjavë

NAPOLI, 16 TETOR - Napoli e ka marrë një lajm të mirë të hënën. Futbollisti nga Kosova, Amir Rrahmani, është shumë afër rikthimit në fushën e blertë, pas një lëndimi që e mbajti jashtë për disa javë. Madje, sipas medieve italiane, përfaqësuesi i Kosovës, i cili ka

munguar në ndeshjet e tetorit, pritet të jetë i gatshëm që në sfidën e fundjavës që do ta ketë Napoli. Skuadra italiane në fundjavë do të ketë punë me Hellas Veronën dhe Rrahmani është duke u diskutuar si opsion për të luajtur nga fillimi. Mbrojtësi i Kombëtares së

Kosovës është lënduar në ndeshjen ndaj Bragas në Ligën e Kampionëve, ku është dashur ta lëshojë fushën në minutën e 13-të për shkak të lëndimit në kofshën e majtë. Ai ka munguar në ndeshjen që Napoli e kishte ndaj Bolognas, po ashtu edhe për Kosovën në

sfidën ndaj Andorrës të enjten e kaluar. E tash Rrahmani pritet të jenë një atu e madhe në fazën defansive për Napolin si dhe për Kosovën në muajin nëntor. Pas 9 xhirove, Napoli është i pesti në tabelë me 14 pikë, shtatë më pak se Milani lider.





Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr.03/L-2012, nenit 4 pika 1 dhe pika 6, nenit 6 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 7 dhe 8.1 (a) të Rregullores nr.1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien në Punë, Rregullores Nr.01/2022 për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 të datës 13.07.2022 dhe vendimit me nr.3844 të datës 16.10.2023, Kryeshefi Ekzekutiv më datë 16.10.2023 rishpall:

KONKURSI JASHTËM

Pozita e punës: Drejtor i Administratës (1 pozitë)

Kohëzgjatja e kontratës: 1 vit, me mundësi vazhdimi

Periudha provuese: 3 muaj

Niveli i Pagës: IV

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punës mund të informoheni përmes web: www.trafikurban-pr.com, në vegzën- Rreth Nesh, Raporte/Rregullore.

Përgatitja profesionale

- Diplomë universitare në Juridik, Administratë Publike apo Ekonomik
- 3 vite përvojë pune profesionale
- Aftësi shumë të mira të punës me kompjuter;
- Aftësi të mira organizative dhe komunikuese;
- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion;

Dokumentacioni i kërkuar:

- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të dëshmuar me Trust.
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje të certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikoj janë përparësi;

-Çdo përgjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Mënyra e Aplikimit:

- Kandidati/ja, mund të dorëzojë këto dokumente në formë fizike në zyrat e Trafikut Urban, përmes postës, dhe në formë të skanuar përmes email: punesimi@trafikurban-pr.com;
- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://trafikurban-pr.com/2022/njoftimet-e-konkurseve/aplikacioni-per-pune/>);

Konkursi është i hapur nga data **17.10.2023** dhe përfundon më datë **31.10.2023** në ora **16.00**.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: **16.10.2023**

1

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" SH.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimin e Bordit të datës 02.10.2023 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendeve të punës për periudhën e ardhshme një vjeqare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 17.10.2023 të shpall:

KONKURSI PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës:

Zyrtar/e Ligjor/e - Mitrovicë me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi
Numri i referencës: 10-02-59

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Zhvillon dhe arrinë pëlqimin për planet e punës dhe afatet, në koordinim me mbikëqyrësin, për zbatimin e procedurave përkatëse, shërbimeve dhe produkteve përkatëse në fushën profesionale specifike;
- Kryen detyrat e parapara me plan të punës të miratuar në përputhje me ligjin, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
- Bënë hulumtime ligjore, analiza, vlerësim të opsioneve dhe rekomandon për shqyrtim dokumentacionin me mbikëqyrësin,
- Merr pjesë në seanca gjyqësore kur kjo i kërkohet;
- Kujdeset për ruajtjen e fshehtësisë zyrtare lidhur me lëndët dhe informatat të cilat i bëhen të ditura gjatë punës;
- Koordinon punën me pjesët tjera të Kompanisë dhe komunikon, sipas nevojës edhe me autoritetet e jashtme, gjithnjë duke u kujdesur për paraqitje të denjë të Kompanisë;
- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.
- Kryen edhe punë tjera të natyrës së ngjajshme të cilat i cakton udhëheqësi drejtëpërdrejtë;

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Të ketë diplomën universitare të Fakultetit Juridik
- Të ketë njohuri të shkëlqyera në interpretimin e ligjeve dhe akteve nënligjore
- Të ketë njohuri të mira të punës me kompjuter (Microsoft, Word, Excel etj.)
- Të ketë aftësi të mira organizative dhe aftësi për të punuar nën presion;
- Aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe punës ekipore;
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe të kryejë detyrat me mbikëqyrje minimale;
- Preferohet njohja e gjuhës serbe dhe angleze

Procedura e Aplikimit:

- Aplikacioni
- CV - ja
- Kopja e Letërnjoftimit
- Letër motivuese;
- Diplomat, Certifikatat dhe dokumentet tjera relevante;
- Deklarata nën betim

Kushtet e veçanta:

Punëtori 6 (gjashtë) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë.
Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 17.10.2023 deri më datën 31.10.2023. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



Na osnovu člana 8 Zakona br.03/L-2012, člana 4 tačka 1 i tačka 6, člana 6 stav 2 Administrativnog uputstva br.07/2017 o regulisanju tenderskih procedura u javnom sektoru, članovi 7 i 8.1 (a) Uredbe br.1074 od 21.08.2017.godine o radnim odnosima i Uredbe br.01/2022 za unutrašnju organizaciju i sistematizaciju radnih mesta br. 1827 od 13.07.2022 i Odlukom br.3844 od 16.10.2023, izvršni direktor 16.10.2023 ponovo objavljuje:

JAVNI KONKURS

Radno mesto: Direktor uprave (1 mesto)

Trajanje ugovora: 1 godina sa mogućnošću produženja

Probni period: 3 meseca

Nivo plate: IV

Dužnosti i odgovornosti:

O obavezama i odgovornostima posla možete se informisati putem veb-a: www.trafikurban-pr.com, u odeljku O nama, Izveštaji/Redovno.

Stručna priprema

- Univerzitetska diploma prava, javne uprave ili ekonomije
- 3 godine profesionalnog radnog iskustva
- Veoma dobro poznavanje rada na računaru;
- Dobre organizacione i komunikacione veštine;
- Profesionalna etika i sposobnost rada pod pritiskom;

Potrebna dokumentacija:

• Kandidat, ove dokumente moram dostaviti u skeniranom obliku na mejl: punesimi@trafikurban-pr.com;

• Prijava za zapošljavanje (preuzeta sa veb stranice TU <https://trafikurban-pr.com/2022/njoftimet-e-konkurseve/aplikacioni-per-pune/>);

• Dokaz o obrazovanju;

• Kopija lične karte;

• Dokaz o dokazanom radnom iskustvu sa Trustom.

• Dokaz nadležnog suda da se protiv njega ne vodi krivični postupak, ne stariji od 6 meseci;

• Kopije drugih sertifikata vezanih za poziciju za koju konkurišete su prednost;

-Svako falsifikovanje materijala, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna promena u odnosu na informacije date u gore pomenutoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

Opšte informacije:

- Kompanija nudi jednake mogućnosti, podstiče i promovise angazovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.

Način primene:

• Kandidat može dostaviti ove dokumente u fizičkom obliku kancelarijama za gradski saobraćaj, poštom, a u skeniranom obliku na mejl: punesimi@trafikurban-pr.com;

• Prijava za zapošljavanje (preuzeta sa veb stranice TU <http://www.trafikurban-pr.com/shk/job-aplikacioni-shk.html>); Konkurs je otvoren od **16.10.2023** i završava se **31.10.2023** u 16.00 časova.

Napomena: Nepotpuni, neskenirani dokumenti, kao i oni koji pristignu nakon konkursnog roka, neće se razmatrati.

Datum: 16.10.2023

2

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

